



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 37-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 03.09.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Lulzim Rustemi
3. Naxhije Gashi
4. Arben Salihu
5. Slavisa Trajkovic
6. Franjo Goleme
7. Naim Jahiri

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës
2. Zoran Stanojevic ZLK
3. Visar Kozhani-DBF
4. Merita Bytyqi, përkthyesë shqip-shërbisht
5. Fisnik Dida, OSBE

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Zymrije Azemi**

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 37-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informate nga drejtorja për buxhet
3. Raporti i ZLK-s
4. Të ndryshme

Pastaj kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime me qe nuk pati vërejtje as plotësime kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditës se propozuar dhe me te gjitha votat prezentë kaloi.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 37-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 37-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 37-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informate nga drejtorati për buxhet

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Visar Kozhanit nga DBF i cila në pika të shkurta i njoftoi rreth informatës

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Luzlim Buxhjeti, buxhet i mire, është kane mire me pas ma shume pune te ujësullësi por duhet te ketë risi por unë do ta përkrahi.

Naim Jahiri, edhe unë pajtona me parafolësin qe rruga Brus Janjevë duhet te asfaltohet dhe te futet ne buxhet dhe unë përkrahi.

Zoran Cirkovic, ne Grackë nuk jemi te kanqur me asfaltimin e rrugicave te cilat nuk janë punuar mirë nga punëkryesi. Po ashtu rrugica ma e madhe ne fshat ka mbet pa u asfaltuar dhe nuk jemi aspak te kënaqur pasi qe nuk janë konsultuar hiç me banoret e fshatit. Po ashtu kërkoj rrugët te cilat nuk janë asfaltuar te përfshihen ne buxhet.

Arben Saliju, a kanë parapa mjete ne buxhet ne rast te ndonjë katastrofe natyrore?

Zoran Stanojevic, disa rrugë ne Jetën e Re ne Lipjan nuk kane ndriçim, ndërsa ato qe i përkasin komunës se Graçanices kane ndriçim, kërkoj qe te p[parashihen këto rruge ne buxhet.

Skender Biliqi, ne Janjeve rezervari i ujit ka fillu por kur është parapa me mbaru. Ndriçimi është dashtë mu kry a do te kryhet ma vone ose jo. Ne Janjeve po ashtu kanalizimi ka mbet i pa përfunduar.

Zoran Cirkovic, unë e kam shiku ketë buxhet jam ardhe ne konstatim qe ne ketë buxhet askund nuk është e përfshimë Gracka e vjetër.

Visar Buxheti, do te mundohemi aq sa mundemi me i përfshi ne buxhet ato qe janë me te kërkuara nga qytetaret.

Me qe diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën ne vazhdim.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Zoran Stanojevic nga ZLK e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZLK-së

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Naim Jahiri, ne Sllovi një familje a i keni ndihmuar ma frik.

Zoran Cirkovic, ne Gracke a është ndihmuar ndokush ose a ka pas përfitues.

Arben Salihu, familjet qe kerkojne ndihma vazhdimisht a ka mundësi qe te kenë ndonjë biznes te vogël.

Zoran Stanojevic, disa familje janë ndihmuar me ndihma, por sa i përket për biznese aty nuk po ka shume te interesuar pasi qe edhe nuk po dine shume si te aplikojnë.

Meqë çështje të tjera nuk pati u kalua në pikën:

IV

Të ndryshme

Skender Bikliqi, pasi qe si duket mbledhja e fundit kjo do te jete, unë ju falënderoj për bashkëpunimin qe kemi pas si komitet.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15³⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi